Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0799

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi ndërtimor e arkitektonik i objekteve te trajtimit dhe shpërndarjes" me numër të prokurimit 70433736-23-8926-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" Sh.A., më 15/01/2024, mori këtë:

Vendim

1.Refuzohet si e pabazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., me nr. 2023/0799 , e datës 12/10/2023, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" Sh.A, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi ndërtimor e arkitektonik i objekteve te trajtimit dhe shpërndarjes" me numër të prokurimit; 70433736-23-8926-5-2-1.

2. Mbetet në fuqi "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" dates 29.09.2023, AK/ Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" Sh.A, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi ndërtimor e arkitektonik i objekteve te trajtimit dhe shpërndarjes" me numër të prokurimit; 70433736-23-8926-5-2-1.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës ndaj Operatorit ekonomik, në shumën e deponuar për paraqitjen e ankesës, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.08.2023, Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" Sh.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mirëmbajtja e ndriçimit publik".

Ndërsa me datën 29.09.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Beni Company".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 120,000 €.

Me 04.10.2023, OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12/10/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., me nr. 799/23 lidhur me aktivitetin "Rehabilitimi ndërtimor e arkitektonik i objekteve te trajtimit dhe shpërndarjes "me numër të prokurimit 70433736-23-8926-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi ankimore **"**Përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e keni rekomanduar për kontratë Beni Company Sh.P.K. neve na keni eliminuar për makineri edhe pse kem dërgua sqarimin e kërkuar nga ju. Edhe pas kërkesë për ri-shqyrtim prapë AK-ja ka vepruar kundër ligjit dhe RROUP. Ne kërkesë për qasje ne dokumentacion me dt. 02.10.2023 AK na ka japin mundësin për qasje menjëherë me dt 03.10.2023 dhe ne qasjen e dokumentacionit të këtij tenderi kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson Kërkesat e kërkuara ne dosjen e tenderit: Pika I. Ne kërkesën e DT është kërkuar qe: 5.0peratori Ekonomik (tenderuesi) me tenderin e tij duhet të vërtetojë se ka ne pronësi të vet një bager ose mini-bager për nevojat e ekzekutimit të projektit, Dëshmia 5. Kontrata e shitje-blerjes se pajisjes ose fatura e pagesës ose dokumentet për zhdoganimin e pajisjes. Ne në oferte kemi dorëzuar listën marrëveshje me Bageri Company mandej ne kërkesën e juaj për sqarim ne ju kemi dorëzuar kontratën të cilën e kemi me kompani Bageri edhe është plotësuar kjo kërkesë . Ju njoftojmë se kërkesa për letër sqarim nuk na është ardhur ne e-mail mirëpo këtë e kemi vërejtur pasë telefonatës nga zyra e prokurimit, dhe ne atë jemi përgjigjur si AK- duhet të respektoni nenin 38.6 ku ceket se AK- duhet te kërkoj afat kohore të arsyeshëm. Ne kemi ofruar kontratën me Bageri Company e cila kontrate është origjinale dhe e kemi cekun se ne e posedojmë eskavatorin ne punishte tone, ju kemi dhënë sqarim qe nuk është kërkuar transaksioni bankare as fatura. Pika 2. Ne në qasjen e dokumentacioni te OE i rekomanduar për kontrate kemi vërejtur se pagesa e bere përmes e-banking nuk është e saktë sepse për pjesën e pare janë dy data e sistemi i e-banking nuk munde të jep dy data për një pagës, kërkojmë ta vërtetoni nëse keni interes ju si AK- qe ti kërkon qarkullimin bankare kësaj kompanie pasi ka mos përputhje të datave të

transaksionit. Kjo po e kupton qe është shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021. Pika 3. OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën kërkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndërtimtarisë. OE e ka z. Shaqir Halitin i cili është teknik i arkitekturës nuk është teknik i ndërtimtarisë, pasi qe drejtimi ndërtimtari duhet të jete edhe lemia ndërtimtari që të plotësohet ky kusht. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm. Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi, Paragrafi I i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 1, 7, 59, 60, 69 , 72 të LPP-Së . Duke propozuar qe ankesa të aprovohet si e bazuar të anulohet vendimi i AK për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 799/23, ndërsa me datë 08/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0799 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimit për dhënie të kontratës dhe aktiviteti duhet të anulohet.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues pajtohet me rekomandimin e ekspertit. Ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje "

Lidhur me pretendimet e OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0799 ka vlerësuar si në vijim:

-Konstatimi i Ekspertes shqyrtuese ne pretendimin (I)"Në kërkesën e DT është kërkuar qe: 5. Operatori Ekonomik me tenderin e tij duhet të vërtetojë se ka ne pronësi të vet një bager ose mini-bager për nevojat e ekzekutimit të projektit. Dëshmia 5. Kontrata e shitje-blerjes se pajisjes ose fatura e pagesës ose dokumentet për zhdoganimin e pajisjes. Ne në oferte kemi dorëzuar listën marrëveshje me Bageri Company mandej ne kërkesën e juaj për sqarim ne ju kemi dorëzuar kontratën të cilën e kemi me company Bageri edhe është plotësuar kjo kërkesë e juaj. kërkesa për letër sqarim nuk na është ardhur ne e-mail mirëpo këtë e kemi vërejtur pasë telefonatës nga zyra e prokurimit, dhe ne atë jemi përgjigjur si AK- duhet të respektoni nenin

38.6 ku ceket se AK duhet të kërkoj afat kohore të arsyeshëm. Ne kemi ofruar kontratën me Bageri Company e cila kontrate është origjinale dhe e kemi cekun se ne e posedojmë eskavatorin ne punishte tone, ju kemi dhënë sqarim qe nuk është kërkuar transaksioni bankare as fatura."

Sa i përket pretendimit të parë, eksperti shqyrtues sqaron se pasi që OE ankues nuk i kishte përmbushur kërkesat sipas DT-së sa i përket pikës 5, që operatorët të kenë në pronësi një bager ose mini-bageri i cili duhet të dëshmohet përmes kontratës së shit-blerjes ose faturës ose dokumentit të zhdoganimit, ku OE ankues kishte ofruar dëshmi listën e makinerisë ku OE ankues deklarohet se makina qe posedon është në pronësi të një operatori tjetër, përkatësisht të Bageri. Autoriteti Kontraktues përmes një kërkese për sqarim të bërë herën e parë kishte kërkuar që të dërgohet dëshmia sipas kërkesave të DT-së, ku sipas AK, OE ankues kishte deklaruar se tani ka kontratë të shit-blerjes dhe një gjë e tillë kishte ngritur dyshime të komisioni i vlerësimit, ku AK për këtë arsye, me datë 25/09/2023 kishte bërë edhe njëherë kërkesë për sqarim, duke kërkuar nga OE ankues që brenda një afati të paraparë, përkatësisht deri më datë 27/09/2023 në ora 10:00 të dërgoj dëshmi të tjera si kopje e transaksionit mbi pagesën e bagerit të blerë përkatësisht kopjen e faturës së paguar nga ana e Operatorit ose kopjen e noterizuar të kontratës ose kopjen e lejes se qarkullimit në emër të kompanisë. Pas kësaj kërkese, eksperti sqaron se OE ankues nuk i është përmbajtur afatit të caktuar nga AK për të sqaruar atë kërkese dhe madje nuk kishte bërë asnjë kërkesë shtesë për shtyerje të afatit. Duke u bazuar në Neni 38, Sqarimi i Tenderëve, përkatësisht pika 6 dhe 7 e këtij neni theksojnë si në vazhdim: 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre; 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet. OE ankues pretendon se nuk ka marr njoftim përmes e-mailit, andaj i i është përgjigjur me vonesë kësaj kërkesë të AK-së, përkatësisht përgjigja është kthyer me datë 27/09/2023 në orën 16:35, pra disa orë pas afatit të caktuar, duke marr parasysh faktin se OE ankues nuk kishte bërë as kërkesë për shtyerje të afatit, mendimi i ekspertit është që pasi që OE nuk i është përgjigjur AK-së në kërkesën për sqarim me kohë, sipas legjislacionit, përkatësisht dy neneve të lart-cekura, përgjigja pas afatit nuk mund të pranohet. Andaj nga ajo se çfarë sqaruam më lartë, konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i pabazuar."

-Konstatimi i ekspertes shqyrtuese ne pretendimin nr. (II) "Ne në qasjen e dokumentacionit te OE i rekomanduar për kontrate kemi vërejtur se pagesa e bere përmes e-banking nuk është e saktë sepse për pjesën e pare janë dy data e sistemit I e-banking nuk mund të jep dy data për një pagës, kërkojmë ta vërtetoni nëse keni interes ju si AK- që ti kërkon qarkullimin banker kësaj kompanie pasi ka mos përputhje të datave të transaksionit. Kjo po e kupton qe është shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021." Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i ngritur nga OE ankues nuk është i bazuar, për faktin që përveç dy transaksioneve bankare të realizuara dhe të bashkëngjitura në ofertë nga OE i rekomanduar, si dëshmi për blerjen e mini-eskavatorit, po ashtu bashkëngjitur gjendet edhe deklarata nga Noteri, përmes të cilës shihen qartë datat e shit-blerjes së kësaj pajisje dhe mënyrat e realizimit të pagesave, ku edhe data e kësaj deklarate përmes të cilës pranohet se shuma e parë e pagesës është e realizuar, është në përputhje me dëshminë e parë të pagesës, përkatësisht të dy këto dokumente kanë datën e njëjtë, 08/02/2021 që vërtetojnë vlefshmërinë e tyre."

-Konstatimi i ekspertes shqyrtuese ne pretendimin nr. (III) "OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën kërkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar të ndërtimtarisë. OE e ka z. Sh.H i cili është teknik i arkitekturës nuk është teknik i ndërtimtarisë, pasi qe drejtimi ndërtimtari duhet të

jete edhe lemia ndërtimtari që të plotësohet ky kusht. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulet siç parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 I LPP-se, sepse e keni rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik te papërgjegjshëm." Sipas DT-së, një ndër kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ka qenë që OE të ofrojnë së paku dy teknik të kualifikuar të ndërtimtarisë, dhe kjo të dëshmohet përmes diplomës ose certifikatës rreth përgatitjes profesionale. Eksperti pasqyron që OE i rekomanduar për z. Sh.H ka sjellur diplomë në lëminë e Ndërtimtarisë, por në profilin e Arkitekturës. Një diplomë e tillë sipas ekspertit nuk mund të konsiderohet se e përmbushë kriterin e teknikut të ndërtimtarisë, për arsye se ndërtimtaria dhe arkitektura janë dy drejtime të ndryshme. Një diplomë me profil arkitekture, nuk mund të konsiderohet se përmbushë kriterin e DT-së për të qenë teknik i ndërtimtarisë, andaj AK ka pranuar një diplomë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e DT-së të cilat janë përpiluar nga vet ata. Nga kjo çfarë sqaruam, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar." Përfundim Duke marr parasysh që në këtë aktivitet prokurimi kanë ofertuar vetëm dy Operatorë Ekonomik dhe nga shqyrtimi i provave dhe fakteve del se asnjëri prej tyre nuk ka përmbushur në tërësi kërkesat e DT-së përmes të cilës mund të rekomandohet për kontratë, atëherë situata reale bënë të pamundur vazhdimin e mëtutjeshëm të këtij aktiviteti prokurimi, andaj eksperti rekomandon që në këtë situatë, ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullorës, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktiviteit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve

ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit,prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) OE ka dorëzuar listen e pajisjeve, ku ka deklaruar 4 pajisje, mes tyre një bager në pronësi të "Bageri" duke dorzëuar DUD por jo edhe marrëveshjen me qira, për këtë AK ka kërkuar sqarime shtesë duke e përcaktuar edhe afatin për kthimin e përgjigjeve por OE ankues nuk është përgjigjur brenda afateve të përcaktuara nga AK dhe tenderi duhet të refuzohet. Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar *në Neni 38, Sqarimi i Tenderëve, përkatësisht pika 6 dhe 7 e këtij neni theksojnë si në vazhdim: 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre; 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet*. OE ankues pretendon se nuk ka marr njoftim përmes e-mailit, andaj i është përgjigjur me vonesë kësaj kërkesë të AK-së, përkatësisht përgjigja është kthyer me datë 27/09/2023 në orën 16:35, pra disa orë pas afatit të caktuar, duke marr parasysh faktin se OE ankues nuk kishte bërë as kërkesë për shtyerje të afatit, mendimi i ekspertit është që pasi që OE nuk i është përgjigjur AK-së në kërkesën për sqarim me kohë, sipas legjislacionit, përkatësisht dy neneve të lart-cekura, përgjigja pas afatitnuk mund të pranohet. Andaj nga ajo se çfarë sqaruam më lartë, konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i pabazuar. Paneli shqyrtues e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues duke e kualifikuar pretendimin si të pabazuar dhe konstatim ky i cili është i mbështetur në dispozitat ligjore të cituara në raportin e ekspertit dhe ankuesi për këtë aktivitet të Prokurimit është i papërgjegjshëm.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë kemi verejtur se pagesa e bere permes e-banking nuk eshte e sakt sepse për pjesen e parë jane dy data, e sistemit i ebanking nuk mund te jep dy data per nje pages, kërkojm ta vertetoni nëse keni interes ju si AK, që ti kërkoni qarkullimin banker kësaj kompanie pasi ka mos perputhje të dative të transaksionit. Kjo po e kupton që është shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021.

Lidhur me këtë eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i ngritur nga OE ankues nuk është i bazuar, për faktin që përveç dy transaksioneve bankare të realizuara dhe të bashkëngjitura në ofertë nga OE i rekomanduar, si dëshmi për blerjen e mini-eskavatorit, po ashtu bashkëngjitur gjendet edhe deklarata nga Noteri, përmes të cilës shihen qartë datat e shit-blerjes së kësaj pajisje dhe mënyrat e realizimit të pagesave, ku edhe data e kësaj deklarate përmes të cilës pranohet se shuma e parë e pagesës është e realizuar, është në përputhje me dëshminë e parë të pagesës, përkatësisht të dy këto dokumente kanë datën e njëjtë, 08/02/2021 që vërtetojnë vlefshmërinë e tyre. Paneli shqyrtues e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues duke e kualifikuar

pretendimin si të pabazuar dhe konstatim ky i cili është i mbështetur në dokumente relevante të paraqitura në ofertë.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ploteson kerkesen 3. Se paku dy-2 teknik të kualifikuar të ndertimtarise. OE e ka z. Sh.H, i cili është teknik i arkitektures nuk eshte teknik i ndertimtarise, pasi që drejtimi ndertimtari duhet të jetë edhe lemia ndertimtari që të plotesohet ky kusht. Gjithashtu nuk eshte respketuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi i pergjigjshem me cmimin me te ulet siç paraqshihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 I LPP-se, sepse e keni rekomanduar per kontrate operatorin ekonomik të papërgjegjshëm. Eksperti pasqyron që OE i rekomanduar për z. Sh.H ka sjellur diplomë në lëminë e Ndërtimtarisë, por në profilin e Arkitekturës. Një diplomë e tillë sipas ekpsertit nuk mund të konsiderohet se e përmbushë kriterin e tenikut të ndërtimtarisë, për arsye se ndërtimtaria dhe arkitektura janë dy drejtime të ndryshme. Një diplomë me profil arkitekture, nuk mund të konsiderohet se përmbushë kriterin e DT-së për të qenë teknik i ndërtimtarisë, andaj AK ka pranuar një diplomë e cila nuk është në pëputhje me kërkesat e DT-së të cilat janë përpiluar nga vet ata. Nga kjo çfarë sqaruam, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar. Paneli shqyrtues në këtë rast nuk e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues i cili nuk është i mbështetur me asnjë fakt/provë apo dispozitë ligjore lidhur me këtë paneli shqyrtues pas shfletimit të ofertës së OE të rekomanduar shihet se z.SH.H në diplomën e tij ka diplomën e tij në lëmin e ndërtimtarisë profili arkitekturë dhe kemi të bëjmë për një teknik të ndërtimtarisë jo për ndonjë inxhinier apo ndonjë pozitë kyqe menaxheriale dhe paneli shqyrtues vendos që sa i përket këtij pohimi ankimor ta mbështet përgjigjen e autoritetit kontraktues dhe pretendimin ankimor ta kualifikoj si të pa bazuar.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me

kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- OE - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: